



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 15 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju informojmë mbi pyetjet e përcjella nga ana juaj si më poshtë:

**Pyetja nr.1: Në këtë dokument, parashikohet rritja e normës së shqyrtimit të çështjeve për gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit. Në strategji thuhet se grupi i punës është bazuar në një mesatare të produktivitetit të gjyqtarëve gjatë viteve të fundit. Bazuar mbi këtë KLGJ parashikon skenarë të rritjes së këtij produktiviteti, me 10, 20 apo 50%. Ndërkohë bazuar në sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve nga KLD në vitin 2010,( kur nuk kishte vakanca në sistem) norma rezulton më e ulët, se mesatarja aktuale e produktivitetit të gjyqtarëve, dhe disa herë me e ulët se skenari i rritjes së produktivitetit në strategji, ndërkohë që sistemi vuan nga mungesat e gjyqtarëve. Përse nuk i jeni referuar në strategji vendimit të KLD në lidhje me ngarkesën sasiore?**

Është e ditur se gjykatat shqiptare po përballen me një numër të lartë çështjesh që janë në pritje të gjykimit. Ngarkesa e çështjeve të prapambetura është shkaktuar nga një sërë faktorësh, ku përmendet si më kryesori proçesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Gjykatat në vitet e fundit janë përballur me një numër të lartë vakancash. KLGJ si organi qeverisës i gjyqësorit ka ndërmarrë një sërë hapash për zgjidhjen e kësaj situatë.

Duhet theksuar se gjendja më problematike paraqitet në Gjykatën e Lartë, e cila sot është e plotësuar totalisht me 19 gjyqtarë. Gjithashtu, progres pozitiv ka pasur edhe plotësimi i vakancave në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, nëpërmjet aplikimit nga KLGJ të një sërë mekanizmash si skema e delegimit apo transferimet e përkohshme dhe ngritjet në detyrë në gjykatat më të larta dhe ato të specializuara. Rëndësi të veçantë i është kushtuar plotësimit të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, ku tashmë kemi një gjykatë të posaçme apeli funksionale, me 10 gjyqtarë nga 11 që ka organika. Ndërkohë, gjatë vitit 2023, KLGJ përmbylli me sukses plotësimin e 3 vakancave në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke e plotësuar këtë gjykatë me 9 gjyqtarë nga 16 që ka organika dhe aktualisht vijojnë procedurat e verifikimit për 3 pozicionet e tjera të shpallura.

Këshilli ka qenë i angazhuar në përgatitjen dhe zbatimin e plotë të një harte të re gjyqësore me qëllim rritjen e efektivitetit, shpërndarjen e barabartë të punës dhe reduktimin e kostove. Pas përfundimit të këtij procesi të rëndësishëm me Urdhrin nr.42, datë 20.07.2023, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, është ngritur Grupi i Punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” të ndryshuar. Ky Grup Pune ka në përbërje të tij anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtues të gjykatave kryesore, si dhe janë ftuar të marrin pjesë përfaqësues nga Këshilli i Evropës, nga projektet EWMI/INL, projekti EU4 Justice, financuar nga BE etj.

Detyrat kryesore të Grupit të Punës janë:

- i. Vlerësimi dhe analizimi i situatës lidhur me numrin e çështjeve të prapambetura në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatat e Shkallës së Parë Administrative dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;
- ii. Identifikimi i shkaqeve të krijimit të stokut të çështjeve të prapambetura dhe propozimi i masave konkrete për zgjidhjen dhe adresimin e tij;
- iii. Hartimi i një plan veprimi me masa konkrete që grupi do të vlerësojë të nevojshme por pa u kufizuar në:
  1. Vlerësimin e situatës mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve dhe hartimin e propozimit për afatet standarde kohore (standartet minimale të afatit) për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore;
  2. Vlerësimin e nevojës për caktimin e standardeve sasiore dhe hartimin e propozimit mbi normën e likuidimit të çështjeve për gjyqtar, sipas kategorive të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave;
  3. Vlerësimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe hartimin e propozimit përkatës;
  4. Vlerësimin e numrit të nevojshëm për ndihmës ligjorë në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe atë Administrativ, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën Administrative të Apelit dhe hartimin e propozimit përkatës;

Grupi i punës në koherencë të situatës aktuale të sistemit, ka përcaktuar standarde kohore pas një procesi të gjerë konsultimesh me gjykatat, si edhe mbledhjen e raporteve periodike prej tyre. Në këtë aspekt, grupi i punës ka hartuar projektvendimin “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore të gjykimit të çështjeve”. Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë për referencë të dhëna statistikore të mbledhura gjatë krijimit të hartës së re gjyqësore si edhe janë mbajtur në konsideratë standartet e vendosura në vendimin 261/ 2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” të ish KLD, të cilat merren si matës për vlerësimin e gjyqtarëve.

Standartet minimale kohore janë ndarë duke patur parasysh të dhënat statistikore në lidhje me: për sa kohë janë gjykuar pjesa më e madhe e chështjeve duke i grupuar në varësi të llojit të tyre, objektit apo kompleksitetit

Përpos kësaj, standardet janë hartuar edhe duke u përshtatur me situatën aktuale të sistemit gjyqësor pasi sistemet e mëparshme të vlerësimit të përcaktuara në kohën e ish-KLD-së i referohen një periudhe kohore ku gjendja e gjyqësorit dhe rrethanat nuk kanë qenë si në ditët e sotme. Sistemi sot përballet me një sërë problematikash të ndikuara kryesisht nga rritja e numrit të vakancave në gjykata si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar. Për normimin e gjyqtarëve është vlerësuar e nevojshme përcaktimi i rregullave të reja në përputhje me rrethanat e ndodhura në vitet e fundit.

Po ashtu draft- strategjia ka parashikuar edhe një sërë masash që synojnë rritjen e produktivitetit në punën e gjyqtarëve e për pasojë arritjen e proporcionalitetit me standardet e parashikuara. Vlen të përmendet se burimet njerëzore në gjykata nuk përfshijnë vetëm numrin e gjyqtarëve por edhe personelin mbështetës. Si rrjedhojë drafti ka parashikuar një sërë elementësh që do të ndihmojnë gjyqtarët në punën e tyre nëpërmjet miratimit sa më parë të ndryshimeve ligjore që synojnë të menaxhojnë uljen e numrit të chështjeve të prapambetura në gjykata, rritje të numrit të gjyqtarëve në detyrë si dhe rritje e numrit të stafit mbështetës në gjykata përfshirë edhe ndihmësit ligjorë, për të cilët parashikohet të ketë edhe një thjeshtëzim të procedurave të rekrutimit.

Gjithashtu ndër masat e parashikuara është edhe delegimi i detyrave të caktuara në fazën paraprake të një gjykimi ose në përfundim të tij nga gjyqtari te stafi mbështetës i gjykatës, nxitja e shkëmbimit të versioneve elektronike të dokumenteve gjyqësore si vendimeve gjyqësore ndërmjet gjykatave apo aktorëve të tjerë në proces, zhvillimi i seancave gjyqësore në distancë apo përdorimi i modeleve standarde të vendimeve të gjykatës dhe dokumenteve të tjera.

Duhet theksuar se draft- strategjia është ende një dokument i pa finalizuar dhe në konsultim të vazhdueshëm me partnerët deri në finalizimin e tij.

**Pyetja nr.2: A mund të merret për bazë numri i chështjeve të gjykuara në këtë periudhë, kur gjasat janë që produktiviteti të jetë rritur në mënyrë të sforcuar për shkak të presionit për të shtuar sasinë si pasojë e kërkesës së publikut për gjykim brenda afateve të arsyeshme?**

Grupi i Punës me qëllim analizimin e kohëzgjatjes së chështjeve të gjykuara dhe chështjeve të prapambetura (backlog) si dhe përcaktimit të standardeve kohore, ka marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka analizuar statistikat e chështjeve të gjykuara për periudhën 2013-2023. Ndërsa për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë marrë të dhëna për periudhën kohore 2015-2023. Bazuar në analizën që përmban raportin, për secilën nga gjykatat janë propozuar standardet përkatëse afatgjata. Duhet theksuar se masat e parashikuara nga grupi i punës nuk bazohen vetëm në praktikën ndërkombëtare për uljen e numrit të chështjeve të prapambetura por edhe në masat e zbatuara tashmë nga Gjykata e Lartë për të përballuar ngarkesën e chështjeve të prapambetura.

Analizimi i situatës është në përputhje me gjendjen aktuale dhe problematikat që e bëjnë të nevojshme këtë strategji, deri në normalizimin e situatës, konsolidimin e efekteve të hartës së re gjyqësore dhe pasojave që do sjelli implementimi i një strategjie. Kjo e fundit mbetet ende një dokument në diskutim dhe konsolidim e sipër.

**Pyetja nr.3: A ka parashikim ligjor për caktimin e një norme sasiore për gjyqtarët, pasi kriteret e KLD zbatohen për vlerësimin profesional të gjyqtarëve dhe nuk janë detyruese?**

Një ndër detyrat e grupit të punës ka qenë edhe përcaktimi i afateve standarde minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve, si një nga masat që do të ndihmojë në uljen e backlog-ut si dhe do t'i shërbejë edhe Këshillit si matës për vlerësimin e gjyqtarëve (pasi aktualisht afatet maten ende me vendimin e ish-KLD-së të vitit 2010). Në hartimin e këtij projektvendimi janë marrë për referencë të dhëna statistikore të mbledhura gjatë procesit të krijimit të hartës së re gjyqësore, si dhe duke mbajtur parasysh edhe standardet e vendosura në vendimin e vitit 2010 të ish-KLD-së. Përsërisim se këto kriteret mbahen në konsideratë në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve sipas standardeve të parashikuara në “Metodologjinë e Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit dhe nuk kanë fuqi detyruese pro janë orientuese për efekt të këtij procesi.

Sa i përket standardeve minimale kohore, është bërë një ndarje e tyre duke pasur parasysh të dhënat statistikore në lidhje me: për sa kohë janë gjykuar pjesa më e madhe e çështjeve duke i grupuar çështjet në varësi të llojit të tyre, objektit apo edhe kompleksitetit të çështjeve. Gjithashtu është mbajtur parasysh dhe neni 399 i K.Pr.Civile në lidhje me afatet e arsyeshme. Ndërsa lidhur me standardet minimale sasiore janë analizuar sa ka rezultuar numri i të dhënave statistikore edhe gjatë studimit për sa i përket hartës së re gjyqësore ku është përcaktuar sa çështje gjykojnë gjyqtarët referuar çështjeve të cilat janë komplekse (me palë kundërshtare) dhe çështjet e lehta që përgjithësisht kanë qenë çështje pa palë kundërshtare.

Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjyqtarët, është konceptuar me qëllim rritjen e efikasiteti të gjykatave duke u bazuar në parimet e efektivitetit, transparencës dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Këshilli synon vendosjen e standardeve të njëjta për të gjithë gjyqtarët ngarkesë të ekuilibruar në gjykata dhe rritjen e besimit të publikut në gjyqësor. Këto standarde në momentin që do jenë finalizuar dhe miratuar do jenë pjesë e rregullave të brendshme të gjykatës sipas parashikimeve të Nenit 94, Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemi të drejtësisë”, i ndryshuar.

**Pyetja nr.4: Nëse KLGJ miraton sërish një akt me natyrë orientuese, çfarë na bën të besojmë se gjyqtarët do të realizojnë kriterin sasior të draft strategjisë. A është ky një mekanizëm për motivimin e gjyqtarëve?**

Akti i mësipërm lidhur me standardet minimale kohore dhe sasiore vjen si rrjedhojë edhe e detyrimit ligjor parashikuar nga neni 94 si më sipër, i cili parashikon si një ndër kompetencat e KLGJ-së edhe miratimin e rregullave standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave. Në rregullat standarde për efizienzën e gjykatave përfshihen edhe afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, apo rregulla standarde që do të përdoren nga gjykatat për përcaktimin e afateve kohore, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve.

Sjellim në vëmendje se, në projektvendim është parashikuar që kryetarët e gjykatave do të monitorojnë zbatimin e afateve minimale standarde kohore dhe standardeve minimale sasiore, çdo 3 muaj dhe do përcjellin raportin përkatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pra do të jetë një formë mekanizmi i llogaridhënies lidhur me këtë aspekt, e cili parashikohet të nxisë gjyqtarët në përmbushjen e normave të caktuara në këtë akt. Gjithashtu, norma sasiore e vendosur për gjyqtarët e cila do të reflektohet edhe në aktet që pritet të miratohen nga Këshilli, do të ketë efekt edhe në kuadër të procesit të vlerësimit etik e profesional të tyre, pra mund të konsiderohet mekanizëm motivimi për ta.

**Pyetja nr.5: KLGJ parashikon në draft edhe rritjen e stafëve jo gjyqtarë në gjykata, inventarizimin, trajnimin e stafit, propozime për ndryshime ligjore për rekrutimin e ndihmësve ligjore etj, si dhe plotësimin e vazhdueshëm të vakancave. Rritja e normës sasiore për gjyqtarët parashikohet në Prill. Nga ana tjetër masat e propozuara që u vijnë në ndihmë gjyqtarëve dukshëm nuk mund të realizohen paralelisht. A është realist objektivi për caktimin e një norme në këto kushte?**

Për një strategji efektive për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura në të ardhmen, është thelbësore që gjykatat të kenë standarde minimale kohore dhe sasiore të përditësuara, të bazuara në performancën mesatare ndër vite të gjykatave shqiptare dhe në procedurë. Përcaktimi i standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjyqtarët është një ndër objektivat e draft - strategjisë dhe aktualisht jemi në fazën e hartimit të projektvendimit përkatës. Vlerësojmë se rritja e normës sasiore të gjyqtarëve do të ketë impakt të padiskutueshëm në reduktimin e çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallëve të para dhe të apelit.

Në fazën fillestare të zbatimit të strategjisë këtë objektiv e shohim si një objektiv ambicioz, në përputhje me situatën aktuale të sistemit. Përmbushja e tij optimale do të ndodhë me plotësimin e gjithë komponentëve të tjerë të draft - strategjisë, por nuk mund të mbetet asnjë proces peng i një procesi tjetër që sigurisht do jetë vlerë e shtuar në vijim për situatën.

**Pyetja nr.6: A mendoni se ka vend për përmirësime dhe ndryshime të rregullave për plotësimin e vendeve vakante, pasi procedurat aktualisht zgjasin edhe mbi një vit? Në draft strategji nuk ka masa konkrete për plotësimin e shpejtë të vendeve vakante, kur nga ana tjetër në dy gjykatat e Apelit atë administrative dhe të**

**juridiksionit të përgjithshëm, dukshëm vakancat janë shumë më të larta se sa procedurat e nisura nga KLGJ.**

Këshilli është angazhuar maksimalisht në proceset e lëvizjeve paralele dhe ngritjeve në detyrë në gjykatat më të larta apo gjykatat e posaçme. Janë respektuar dhe përmbushur të gjitha afatet ligjore në të gjitha fazat e tyre. Megjithatë ky proces nuk varet vetëm nga Këshilli por është i ndërvarur nga një sërë institucionesh të tjera dhe një sërë procedurash verifikimi. Për qëllime të këtyre verifikimeve, KLGJ bashkëpunon me një sërë institucionesh si ILDKPKI, BKH, organet tatimore dhe doganore, gjykatat, prokuroritë, shërbimet e inteligjencës shtetërore, ILD etj. Në këto kushte grupi i punës nuk mund të disponoj përtej kompencave kushtetuese të Këshillit. Gjithashtu, sjellim këtu në vëmendje që procedurat e verifikimit zhvillohen paralelisht edhe me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional.

Të gjitha këto procedura janë të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe janë në përputhje me qëllimet e reformës në drejtësi.

Po ashtu me qëllim shmangien e vakancave të krijuara në sistem janë aplikuar nga KLGJ edhe mekanizmat plotësues si skema e delegimit, transferimet e përkohshme apo caktimi i gjyqtarëve në çështje të veçanta. Ndërkohë që vijon intensivisht puna për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

**Pyetja nr.7: A ishte e mjaftueshme koha e diskutimit të draftit me trupat gjyqësore dhe si u prit prej tyre?**

Nevoja për përgatitjen e një strategjie për uljen e ngarkesës së çështjeve gjyqësore është e një natyre emergjente për shkak të situatës aktuale të ngarkesës në sistem. Për këtë arsye, që prej ngritjes së tij në korrik 2023, Grupi i Punës për Strategjinë e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura ka patur një aktivitet intensiv duke zhvilluar 13 mbledhje deri në miratimin e draftit të strategjisë, në muajin mars 2024. Gjatë kësaj periudhe Grupi i Punës ka realizuar konsultime me ekspertë vendas dhe ndërkombëtare sikurse dhe me gjyqtarë të gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallëve të para, të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ. Takimet konsultative kanë qenë mjaft të shpeshta dhe janë zhvilluar edhe pranë ambienteve të gjykatave respektive, ku gjyqtarët kanë shprehur vlerësimet e tyre. Në kuadër të këtyre takimeve janë dhënë opinionet përkatëse nga gjyqtarët të cilët mbi të gjitha kanë vlerësuar iniciativën për hartimin e kësaj strategjie të konsideruar tepër të nevojshme në kushtet në të cilat gjendet sistemi gjyqësor aktualisht.

Po ashtu vlen të përmendet se gjatë veprimtarisë nga ana e grupit të punës janë hartuar/miratuar aktet e mëposhtme:

- Strategji e uljes së numrit për parandalimit të çështjeve të prapambetura e backlogut për Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Gjykatat e Apelit;
- Studim paraprak për kohëzgjatjen e çështjeve, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

- Studim paraprak për kohëzgjatjen e çështjeve, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- Studim paraprak për kohëzgjatjen e çështjeve, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
- Parashikim në lidhje me uljen e backlog-ut në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Parashikim në lidhje me uljen e backlog-ut në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- Parashikim në lidhje me uljen e backlog-ut në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Parashikim në lidhje me uljen e backlog-ut në Gjykatën Administrative të Apelit.
- Qasje Strategjike për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe gjykatat administrative në Shqipëri;
- Udhërrëfyes për një strategji për uljen e backlog-ut;
- Udhëzuesi “Për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve gjyqësore”;
- Raport vlerësues i grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata “Për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Projektudhëzim “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata”; (Inventarizimi)
- Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 78, datë 30.05.2029 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”;
- Projektvendim “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore të gjykimit të çështjeve”;
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar;
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar;
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; (lidhur me lëshimin e Urdhrave të ekzekutimit)
- Draft “Strategjia kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” 2024-2027.

**Pyetja nr.8: Aktualisht Draft- Strategjia për uljen e bekklogut është ende një draft, a mund të merren në konsideratë dhe vërejtjet apo sugjerimet e gjyqtarëve?**

Sikurse është cituar më sipër, grupi i punës gjatë veprimtarisë së tij për hartimin e strategjisë, planit të veprimit si dhe masave konkrete është konsultuar vazhdimisht edhe në takime periodike me trupën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ Tiranë si dhe me dy gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm dhe ai administrativ. Komentet dhe sugjerimet e tyre janë mbajtur në vëmendje edhe sa i përket hartimit të projektakteve nga Grupi i Punës duke u mundësuar kështu pasja e një roli aktiv nga vetë gjyqtarët në hartimin e kësaj strategjie. Megjithatë draft strategjia mbetet ende në nivelin e një projekt-dokumenti, dhe në vijim mund të ketë ndryshime në bazë të sugjerimeve nga palët e interesit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!